UDHËZIM
Nr. 3, datë 24.3.2016

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË MATURËS SHTETËRORE 2016

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

Lëndët dhe datat e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore

1. Lëndët dhe datat e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore janë:

a) Gjuhë e huaj
4 qershor 2016;

b) Gjuhë shqipe dhe Letërsi11 qershor 2016;

c) Matematikë
17 qershor 2016;

d) Provime me zgjedhje 24 qershor 2016.

Neni 2
Administrimi i provimeve

1. Administrimi i provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 bazohet në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 91, datë 2.3.2016, të ministrit të Arsimit dhe Sportit.

2. Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Provimeve, brenda muajit mars 2016, përcaktojnë llojin e testeve për secilin provim kombëtar të Maturës Shtetërore (të detyruar dhe me zgjedhje).

Neni 3
Masa për mbarëvajtjen e provimeve

1. DAR/ZA-tëtë marrin nga shkollat listat e maturantëve mbetës të vitit mësimor 2015–2016, brenda datës 3 qershor 2016, dhe t'i pasqyrojnë ato në sistemin elektronik "Matura *online*", sipas udhëzimit përkatës. DAR/ZA-të dërgojnë në AKP, të printuar dhe në kopje elektronike, listat e maturantëve mbetës të vitit për çdo shkollë.

2. Drejtoritë e shkollave njoftojnë maturantët mbetës, që të mos paraqiten në provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016, pa likuiduar më parë provimet e klasës.

3. Organizimi i konsultimeve për maturantët kryhet sipas procedurave të përcaktuara në urdhrin e ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 121, datë 25.2.2011, "Për organizimin e konsultimeve në ndihmë të nxënësve maturantë".

4. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 zhvillohen dhe organizohen sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

5. Provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 zhvillohen në mjediset e institucioneve arsimore, sipas parashikimeve përkatëse të Rregullores së Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

6. Teza e provimit "Gjuhë dhe letërsi greke" për shkollën e mesme pedagogjike të pakicës kombëtare greke përgatitet nga DAR-ja Gjirokastër.

7. Teza e provimit "Gjuhë dhe letërsi italiane" (Lingua e literatura italiana) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane përgatitet nga Ministria e Arsimit e Republikës së Italisë dhe provimi zhvillohet në datën 23 maj 2016 në shkollat përkatëse.

8. Teza e provimit "Gjuhë frënge" (DELF B2 scolaire) për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-franceze përgatitet nga Ambasada Franceze dhe provimi zhvillohet në datën 23 maj 2016 në shkollat përkatëse.

Tërheqja e testeve të provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 bëhet sipas grafikut të hartuar nga AKP-ja dhe të miratuar nga MAS-i. Përfaqësuesit e Postës Shqiptare tërheqin në AKP materialet e provimit, një ditë para zhvillimit të provimit përkatës. Materialet e provimit janë të paketuara për çdo mjedis më vete. Shpërndarja dhe grumbullimi i materialeve të provimit bëhet sipas parashikimeve përkatëse në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4

Provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore

1. Provimet e detyruara dhe me zgjedhje fillojnë në orën 10:00.

2. Hartimi i testeve të provimeve të detyruara dhe atyre me zgjedhje bëhet sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e Maturës Shtetërore 2016 në Republikën e Shqipërisë.

3. Testi për secilin nga provimet e detyruara përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (13 pikë gjithsej) dhe 12 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 50 pikë.

4. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje përmban 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje janë me përgjigje alternative, që vlerësohen me një pikë secila (10 pikë gjithsej) dhe 10 pyetje me zhvillim, të cilat vlerësohen me 30 pikë. Testi vlerësohet maksimalisht me 40 pikë.

5. Provimet e detyruara zgjasin 2 orë e 30 minuta.

6. Testi i provimit të detyruar të gjuhës së huaj hartohet, administrohet dhe vlerësohet nga AKP-ja.

7. Testi i provimit me zgjedhje të gjuhës së huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test" hartohet dhe vlerësohet nga ETS Global, në bazë të marrëveshjes ndërmjet Education Testing Service Global BV dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

8. Provimet me zgjedhje zgjasin 3 orë. Provimi i gjuhës së huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test" zgjat 1 orë e 55 minuta.

9. Maturantët/kandidatët që japin provim vetëm njërën nga lëndët me zgjedhje, fillojnë provimin në orën 11:30 dhe e përfundojnë atë në orën 13:00.

10. Maturantët/kandidatet që japin dy provime me zgjedhje, ku njëra prej tyre është gjuhë e huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test", hyjnë në provimin tjetër me zgjedhje në orën 11:30. Provimin e gjuhës së huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test" e japin në orën 13:30.

11. Kandidatët që japin provim me zgjedhje vetëm gjuhën e huaj Anglisht "TOEFL Junior Standard Test", hyjnë në provim në orën 13:30.

12. Maturantët/kandidatët mbetës në provimet kombëtare të Maturës Shtetërore 2016 i rijapin këto provime në sesionin e dytë.

Neni 5

Dispozita të fundit

Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen zëvendësministri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe njësitë arsimore vendore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla